



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-19-4463-5-1-1/FA108
14 Nr. 1045/19
Dt. 14.10.2019

KONTRATË SHËRBIMI (Kontratë Kornizë)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme PORORSITËSI), dhe
2. “ ILEAA-GR “sh.p.k. me seli në Prishtinë, me ARBK: 810199035 & “ Infra-Plus “sh.p.k. me seli në Prishtinë, me ARBK: 810175225, të cilët i përfaqëson z. Enis Veliqi, në tekstin e mëtejme: KRYESI I PUNIMEVE,

janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për ekzekutimin e shërbimeve dhe / ose punëve, si në vijim :
Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit , me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	44	6	3	5	1	1
Prokurimi Nr.	644	1	9	0	7	2	5	1	1

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës është ekzekutimi i punimeve nga ana e Kontraktuesit, që ka të bëjë me Zgjerimin e rrjetit të ujësjellësitë respektivisht me kyçjet individuale të amvisrive dhe atyre komerciale në fshatrat e Komunës së Vushtrrisë në rrjetin e ujësjellësit të rreth me 9000 amvisrive dhe / ose objekteve komerciale, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : 644-19-072-511.

- 1.1 Kjo kontratë është Kontratë Publike Kornizë dhe fillon së zbatuari nga data 15.10.2019 ndërsa përfundon 36 muaj pas nënshkrimit të kontratës respektivisht më dt. 14.10.2022 dhe e njëjta nuk mundë të zgjatet apo të vazhdohet.
- 1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim dhe / ose ekzekutim të shërbimeve me sasi të tyre përkatëse.
- 1.3 Sasi të shërbimeve dhe ose furnizimeve të saktësuara si në pjesën II. Lista e Çmimeve, (pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Kryesit të Shërbimeve) dhe të kësaj Kontrate nuk janë përcaktuar.
- 1.4 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bëjnë blerjen e shërbimeve të përmendura në pikën 1.1.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Ekzekutimi i punimeve do të filloi jo më larg se 2 (dy) ditë kalendarike pas dërgimit të ftesës nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i Pranimit të punimeve dhe duhen të përfundohen sa më parë me prioritet të lartë dhe brenda një afati të arsyeshëm dhe të pranueshëm kohorë.
- 2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Vlera e parashikuar e përafërt e Kontratës është në shumë prej: 1.800.000,00€
- 3.2 Çmimet njësi të punimeve dhe / ose shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve e paraqitur nga Kontraktuesi, e cila është pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj Kontrate.
- 3.3 Kjo Kontratë Kornizë është me Çmime për njësi të punimeve dhe / ose shërbimeve.
- 3.4 Çmimet e saktësuara si në Përshkrimin e Artikujve pjesë e Dosjes së Tenderit dhe të kësaj Kontrate Kornizë duhet të jenë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës dhe Porosive të bëra. Ato janë të prera dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve.
- 3.5 Pagesat do të bëhen : në pajtim me Situacionet e aprovuar të cilat duhet të pasqyrojnë saktë sasinë - e punimeve dhe / ose shërbimeve të porositura nga Menaxheri i Kontratës - Komisioni i Pranimit të punimeve dhe / ose shërbimeve i Autoritetit Kontraktues.
- 3.6 Shumat do të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kushteve të kësaj Kontrate dhe Kushteve të Përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të saktësuara në Dosjen e Tenderit.
- 3.7 Kontraktuesi ka për obligim që me rastin e fillimit të ekzekutimit të punimeve dhe / ose shërbimeve të respektoj detyrimet e tija në mënyrë që punimet dhe / ose shërbimet të jenë cilësore, në përshtatshmëri të plotë me kushte e kontratës, të përmbushin në tërësi Specifikat Teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit si dhe të respektoj Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës. Kontraktuesi merr për obligim që ekzekutimi i punimeve dhe / ose shërbimeve të porositura të bëhet në mënyrë profesionale duke garantuar përdorim adekuat dhe cilësor të materialeve të porositura (gypit të ujësjellësit dhe elementet tjera përcjellëse të saktësuara në Paramasë/Parallogari) në mënyrë që të garantojnë cilësi të punimeve dhe / ose shërbimeve për një periudhë kohore të saktësuara si në Kushtet e Veçanta të Kontratës respektivisht jo më të shkurtë se 36 muaj nga data e pranimit të punimeve dhe / ose shërbimeve.

Neni 4 Ligji i aplikueshëm

- 4.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 5 Kualiteti

- 5.1 Kualiteti respektivisht cilësia e punimeve dhe / ose shërbimeve duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 6 Garancioni

6.1 Garancioni i cilësisë dhe përshtatshmërisë së ekzekutimit të punimeve dhe / ose shërbimeve është përgjegjësi ekskluzive e Kryesit të Shërbimeve.

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,10% në ditë të vlerës së shërbimeve dhe / ose furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes të çfarëdo artikulli që përgatitet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 9 Nën-kontraktimi

9.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Kryesi i Punimeve dhe / ose Shërbimeve i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Kryesi i Punimeve dhe / ose Shërbimeve nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Kryesin e Punimeve dhe / ose Shërbimeve për vendimin e tij brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

10.1 Autoriteti kontraktues mundet që të ndërpres Kontratën menjëherë pasi të konstatoi se Kryesi i Punimeve dhe / ose Shërbimeve nuk po arrin ta përmbushë Kontratën në pajtim me përshkrimin Teknik të saktësuar në Specifikimin Teknik të Dosjes së Tenderit.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Kryesi i Shërbimeve

11.1 Kryesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Kryesit të Shërbimeve shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Kryesi i Shërbimeve nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 100 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Kryesit të Shërbimeve.

Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

12.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

12.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 13 Komunikimi

13.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Kryesit të Shërbimeve duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Procesverbal i mbledhjes së informatave/vizitës se vendit
- (h) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kryesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kryesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Saranda Cakaj	Emri:	Xhafer Tahiri
Pozita:	Drejtoreshë për Prokurim Publik	Pozita:	Kryetar i Komunës së Vushtrisë
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.10.2019	Data:	14.10.2019
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Për Kontraktuesin:

Emri:	Enis Veliqi
Pozita:	Përfaqësues i Kryesit të Punëve: “ Ilea - GR “sh.p.k. & “ Infra-Plus “ – Prishtinë
Nënshkrimi:	
Data:	14.10.2019
Vula:	



Numri i prokurimit: VU644-19-4463-5-1-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-072-511 Titulli: Zgjedhimi i rrjetit të ujësjellësitë

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
 Në kolonë F, duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8%-apo-18%.
 Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, poashtu çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presjes dhjetore

Kategoria	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)- €	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali me TVSH-€
A	Punët e kycjes dhe materialeve për kycje								(Kategoria A 90% e pikëve në vlersim)
1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt, në çmim të llogaritet kosto e transportit të makinerisë dhe të stafit punues	paushall	1.00	0.13	18.00	0.15	0.13	0.02	0.15
2	Identifikimi i kycjeve shtepjake	copë	1.00	0.11	18.00	0.13	0.11	0.02	0.13
	Gërmimi i kanalit për kycje nga gypi kryesor furnizues në distance mesatare 15.0 m'								
3	Me makinë 80%	m ³	1.00	2.54	18.00	3.00	2.54	0.46	3.00
4	Me dorë 20%	m ³	1.00	0.13	18.00	0.15	0.13	0.02	0.15
5	Furnizimi, transporti, shtrija dhe planifikimi i rrës nën, rreth dhe mbi gypat e ujësjellësit, fraksion 0-16 mm, peratersisht 50% e komplet trasese	m ³	1.00	0.17	18.00	0.20	0.17	0.03	0.20



Numri i prokurimit: VU644-19-4463-5-1-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-072-511 Titulli: Zgjerimi i rrjetit të ujësullsisë

6	Mbulim i kanalit me dheun e gërmuar me ngjeshje, afersisht 30 % e dheut të gërmuar	m ³	1.00	0.13	18.00	0.15	0.13	0.02	0.15
7	Demolimi i trotuareve për vendosjen e gypit të ujësullsit, në qmim të llogaritet rrvendosja e tyre me të gjitha elementet e nevojshme	m ²	1.00	0.11	18.00	0.13	0.11	0.02	0.13
8	Kalimi i gypave të ujësullsit nën asfalt me anë të shpimit, në qmim përfshihen hapja e kanalit në dy skajet e rrugës për vendosjen e makineris shpuese, shpimi i rrugës me diametër Ø150 dhe kthimi në gjendjen e mëparshme dy skajet e rrugës	m'	1.00	0.13	18.00	0.15	0.13	0.02	0.15
9	Furnizimi transporti si dhe vendosja e gypit metalik DN 150 . Në qmim të kalkulohen edhe furnizimi dhe vendosja në veçer e betonit për ankerimin e gypit metalik si dhe të gjitha punet profesionale për lidhjen e gypit metalik	m'	1.00	0.11	18.00	0.13	0.11	0.02	0.13
10	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorit 0-63mm për mbulimin e shtreses së fundit të kanalit me trashësi 25cm dhe per rregullimin e rrugeve	m ³	1.00	0.13	18.00	0.15	0.13	0.02	0.15
11	Ngarkimi dhe transporti i dheut të tepert deri ne deponin e qytetit ose ne vendin ku e cakton organi mbikqyrës deri L=15km	m ³	1.00	0.17	18.00	0.20	0.17	0.03	0.20
12	HDPE100 DN 25mm PN 10bar, mesatarisht 15 m'	m'	1.00	5.08	18.00	6.00	5.08	0.92	6.00



Numri i prokurimit: VU644-19-4463-5-1-1 apo nr. i brendshëm: VU644-19-072-511 Titulli: Zgjerimi i rrjetit të ujësullsisë

13	HDPE100 DN 32mm PN 10bar, mesatarisht 15m'	m'	1.00	0.42	18.00	0.50	0.42	0.08	0.50
	Furnizimi, transporti dhe instalimi i tubave PE 100 RC. Montimi bëhet me saldim ballorë dhe sipas nevojës me elektro-saldim. Në gdim të llogariten kthesat horizontale të gypit dhe bllokut i betonit për stabilizim të gypave në kthesa								
	Specifikimet teknike: Gypit HDPE 100 RC (PN 10 bar) Gypit duhet të jetë në përputhje me standardet- EN ISO 9001:2000 dhe EN ISO 14001:2004 (1996) dhe DVGW, DVS, BGR, 500 (VBG 50)								
14	PE 100 Ø110/PN 10bar	m'	1.00	0.17	18.00	0.20	0.17	0.03	0.20
15	PE 100 Ø75/PN 10bar	m'	1.00	0.13	18.00	0.15	0.13	0.02	0.15
16	PE 100 Ø63/PN 10bar	m'	1.00	0.11	18.00	0.13	0.11	0.02	0.13
17	PE 100 Ø50/PN 10bar	m'	1.00	0.10	18.00	0.12	0.10	0.02	0.12
18	PE 100 Ø40/PN 10bar	m'	1.00	0.08	18.00	0.10	0.08	0.02	0.10
	Furnizimi transporti dhe montimi i gofave mekanike me kthesë 90° gjysëm jichëse nga materiali PE përballimin e kësaj. Montimi i pjesve bëhet sipas vizatimit.								



Numri i prokurimit: VU644-19-4463-5-1-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-072-511 Titulli: Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësive

19	HDPE100 DN 110/25mm PN 10bar	copë	1.00	0.25	18.00	0.30	0.25	0.05	0.30
20	HDPE100 DN 80/25mm PN 10bar	copë	1.00	0.17	18.00	0.20	0.17	0.03	0.20
21	HDPE100 DN 63/25mm PN 10bar	copë	1.00	3.39	18.00	4.00	3.39	0.61	4.00
22	HDPE100 DN 50/25mm PN 10bar	copë	1.00	1.69	18.00	2.00	1.69	0.31	2.00
23	HDPE100 DN 40/25mm PN 10bar	copë	1.00	0.13	18.00	0.15	0.13	0.02	0.15
24	Furnizimi dhe montimi i pusetave të plastikës, me kapacitet për peshë të rëndë deri në 500 kg. Dimensionet e puseta: D=0.5 m, L=0.6 m, H=0.6 m. Në gjim të përfshihet germimin për hapjen e puseta	copë	1.00	22.88	18.00	27.00	22.88	4.12	27.00
25	Gjysem lloshëse 3/4", PN 10 bar	copë	1.00	0.13	18.00	0.15	0.13	0.02	0.15
26	Valvulave sferike 3/4", PN 10 bar	copë	1.00	4.24	18.00	5.00	4.24	0.76	5.00
27	Valvulave jo kthyesë 3/4", PN 10 bar	copë	1.00	0.11	18.00	0.13	0.11	0.02	0.13
28	Kthesa 90° PN 10 bar	copë	1.00	0.13	18.00	0.15	0.13	0.02	0.15
29	Mbledhës mbeturinave 3/4", PN 10 bar	copë	1.00	0.10	18.00	0.12	0.10	0.02	0.12
30	Lidhëse 3/4", PN 10 bar	copë	1.00	0.11	18.00	0.13	0.11	0.02	0.13




Numri i prokurimit: VU644-19-4463-5-1-1 apo n.r. i brendshem: VU644-19-072-511 Titulli: Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësive

31	Gypi HDPE 100 RC 3/4", PN 10 bar	m'	1.00	0.13	18.00	0.15	0.13	0.02	0.15
32	Termozolim per të gjitha pjeset e instaluar	copë	1.00	0.10	18.00	0.12	0.10	0.02	0.12
33	Furnizimi i Ujëmatësit Q3 = 2.5 m ³ /h, 3/4", PN 10 bar (ujëmatësi duhet të përmbaj standardet ISO dhe CE dhe të mos jetë më i vjetër se 2 vite)	copë	1.00	8.47	18.00	10.00	8.47	1.53	10.00
34	Montimi i Ujëmatësit Q3 = 2.5 m ³ /h, 3/4", PN 10 bar (ujëmatësi duhet të përmbajë standardet ISO dhe CE dhe të mos jetë më i vjetër se 2 vite)	copë	1.00	11.02	18.00	13.00	11.02	1.98	13.00
35	Largimi i ujërave me pompë gjatë kohës së egzekutimit të punimeve	orë	1.00	0.13	18.00	0.15	0.13	0.02	0.15
36	Testimi i gypave në përputhshmëri me kushtet teknike	m'	1.00	0.11	18.00	0.13	0.11	0.02	0.13
37	Dezinfektimi i gypave në përputhshmëri me kushtet teknike	m'	1.00	0.10	18.00	0.12	0.10	0.02	0.12
38	Hartimi i projekti detal nga ana e kompanisë, pas perfundimit të projektit "ASB Draiëing", duke përfshi të gjitha elemente percjelle te niveletes situacion, gjatsot, terhor, diagrami i mbushjeve, diagrami i germimeve, etj)	paushall	1.00	0.13	18.00	0.15	0.13	0.02	0.15
TOTALI ME TVSH A:							63.47	11.42	74.89

W



Numri i prokurimit: VU644-19-4463-5-1-1 apo nr. i brendshëm: VU644-19-072-511 Titulli: Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësive

B	Punët e prerjes së asfaltit dhe betonit									(Kategoria B 10% e pikëve në vlersim)
1	Prerja e asfaltit me gjerësi mesatare b=0.7m për vendosjen e gypit të ujësjellësit, në çmim të llogaritet vendosja e zhavorit 0-32mm me t=15cm si dhe riasfaltimi t=10cm	m ²	1.00	25.42	18.00	30.00	25.42	4.58	30.00	
2	Prerja e betonit me gjerësi mesatare b=0.7m për vendosjen e gypit të ujësjellësit, në çmim të llogaritet vendosja e zhavorit 0-32mm me t=15cm si dhe riasfaltimi t=10cm	m ²	1.00	16.95	18.00	20.00	16.95	3.05	20.00	
TOTALI ME TVSH B:							42.37	7.63	50.00	


X


REKAPITULLIMI

Kategoria	Përshkrimi	Çmimi total me TVSH në €	Çmimi total i peshuar
A	Punët e kyçjes dhe materialeve për kyçje	74.89	67.401
B	Punët e prerjes së asfaltit dhe betonit	50.00	5
<p><i>Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në baze të kësaj vlerë). Kjo është vlera e cila do të duhet të shenohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.</i></p>		72.401	



Numri i prokurimit: VU644-19-4463-5-1-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-072-511 Titulli: Zgjerimi i rrethit të ujësjetilistë

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	"LEAA-GR" sh.p.k. & "INFRA-PLUS" sh.p.k.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Enis Veliqi
NËNSHKRIMI:	
DATA:	16.07.2019
VULA:	



Numri i prokurimit: VU644-19-4463-5-1-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-072-511 Titulli: Zgjerimi i rrjetit të ujësjellës

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : gjuhët në përdorim zyrtarë.

Numri i prokurimit: VU644-19-4463-5-1-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-072-511 Titulli: Zgjerimi i rrjetit të ujësjellsitë

Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është : 10 % e çmimit total të kontratës, nga një Bankë apo kompani e sigurimeve e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës. Afati i validitetit të Sigurimit të Ekzekutimit 37 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përherëshme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 25.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar. d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 80.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar e personave të tjerë 80.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar
Programi i ekzekutimit	12.1	Planin për Menaxhimin e Kontratës. Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës dhe jo më gjatë se 36 muaj, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës Punët do të ekzekutohen sipas përvetësimeve buxhetore nga viti në vitë, gjatë kohëzgjatëjes së kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	15.1	Gjitha detyrimet doganore dhe tatimore sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës, bien në barrë të Op.Ek. - Kontraktuesit
Patentat dhe licencat	13.1	N/A

Numri i prokurimit: VU644-19-4463-5-1-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-072-511 Titulli: Zgjerimi i rrjetit të ujësjellsitë

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : 3 (tre) ditë pas nënshkrimit të kontratës, nëse kushtet atmosferike janë të përshtatshme (vlerësimi i Organit Mbikëqyrës të Autoritetit Kontraktues)
	17.2	Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës dhe jo më gjatë se 36 muaj, nga data e fillimit të punimeve
Dëmet e likuiduara	19.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga organi mbikëqyrës, i emëruar enkas nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të punëve- shërbimeve të Autoritetit Kontraktues.
Pagesa	24.2	Do të bëhet sipas situacioneve dhe llogarive të aprovuara nga Organi mbikëqyrës si dhe raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i projektit, pagesa do të kryhet në afate sa më të shkurtë kohor dhe jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit – evidentimit të faturës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë jo më vonë se 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 3 vite pas kryerjes së punëve dhe pranimit teknik.

Numri i prokurimit: VU644-19-4463-5-1-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-072-511 Titulli: Zgjerimi i rrjetit të ujësjellstitë

Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	44.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>